



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Ac.nr.1008/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, nga gjyqtari individual Nehat Idrizi, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit A. A., nga Prishtina, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson S. K., avokat në Prishtinë, ndaj debitorit SHSKUK-Qendra Klinike Universitare-QKUK, Prishtinë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.1274/2020, të datës 01.12.2020, me datë 22.07.2021, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e debitorit SHSKUK-Qendra Klinike Universitare-QKUK, Prishtinë, PRISHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.1274/2020, i datës 01.12.2020 dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe vendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.1274/2020, të datës 01.12.2020, e ka hedhur si të pasafatshëm prapësimin e debitorit SHSKUK-Qendra Klinike Universitare-QKUK, Prishtinë i ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përmbartimit P.nr.711/2020, të datës 28.05.2020.

Kundër këtij aktvendimi ankesë ka parashtruar debitori për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim bërë Gjykatës së Apelit që ankesën e debitorit ta aprovojë si të bazuar ndërsa aktvendimin e atakuar ta prishë dhe lëndën ta kthejë në rigjykim dhe rivendosje ose të njëjtin ta ndryshoj dhe ta hedhë poshtë propozimin për përmbartim si të pa bazë.

Ankesa e debitorit i është dorëzuar kreditorit për përgjigje por i njëjti nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbaremore (LPP), gjeti se:  
Ankesa e debitorit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se kreditoria A. A., nga Prishtina, me datën 28.05.2020, ka paraqitur propozim për përmbareim ndaj debitorit SHSKUK-Qendra Klinike Universitare-QKUK, Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm Vendimit të Inspektoriatit të Punës nr. 01 Nr.21-1715/94 i datës 10.02.2020 i plotfuqishëm nga data 19.05.2020, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet debitori që kreditorit në emër të pagesës së një page jubilarë ti paguaj shumën prej 598.21 Euro dhe shpenzimet e procedurës përmbaremore, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij vendimi.

Përmbareuesi Privat A.M. me seli në Prishtinë duke vepruar sipas propozimit për përmbareim të kreditorit ka lejuar përmbareimin në bazë të vendimit 01 nr.21-1715/94 të datës 10.02.2020 të lëshuar nga Inspektoriatit i Punës i plotfuqishëm që nga data 19.05.2020, me të cilin e ka detyruar debitorin, që kreditorit t'ia paguaj shumën prej 598,21 Euro për borxh në emër të pagesës së një page jubilarë dhe shpenzimet procedurale në shume prej 46.02 Euro.

Kundër urdhrit P.nr.711/20 i datës 28.05.2020, për lejimin e përmbareimit, prapësim ka paraqitur debitori, me arsyetimin se është bërë konstatimi i gabuar i gjendjes materiale pasi që nuk është cekur se në cilat prova është bazuar dhe ka kërkuar që ti bëhet pagesa e një page jubilarë në shumë prej 598,21 Euro pasi që në Vendimin 01 nr.21-1715/94 të datës 10.02.2020 nuk është caktuar shuma e mjeteve monetare të cilat debitori duhet të ja paguaj kreditorit. Tutje, ka shtuar se dokumenti në bazë të cilit është lejuar përmbareimi nuk mund të paraqitet si dokument ekzekutiv dhe se i njëjti nuk është i përshatshëm për përmbareim. Nga Gjykata ka kërkuar që prapësimi i debitorit të aprovohet si i bazuar dhe Urdhëri P.nr.711/20 i datës 28.05.2020 të anulohet dhe propozimi të hedhet poshtë si i pa bazë.

Përgjigje në prapësim ka parashtruar i autorizuari kreditorës me datë, me të cilin ka theksuar se pretendimet e debitorës nuk qëndrojnë me që rast nga Gjykata ka kërkuar që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm duke vendosur sipas prapësimit të debitorit, fillimisht ka shqyrtuar afatshmërinë e prapësimit me çka edhe ka nxjerr aktvendimin e atakuar PPP.nr.1274/2020 të datës 01.12.2020, me të cilin e ka hedhur poshtë si të pas afatshëm prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin përmbareimor P.nr.711/2020, të datës 28.05.2020.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se debitori urdhrin përmbareimor e ka pranuar me datë 02.06.2020, e cila vërtetohet nga fletë kthesa e cila gjendet në shkresat e lëndës, kurse prapësimin e ka ushtruar me datë 10.06.2020, jashtë afatit ligjor të paraparë me dispozitën e nenit 70 të LPP-së, brenda 7 ditëve pas pranimit të vendimit përmbareues ose urdhërit përmbareues.

Gjykata e Apelit qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 182.2 pika n), 183, 127 të LPK-së, e lidhur me nenin 29 paragrafi 1 pika 1.3 e lidhur me nenin 40 dhe 43 paragrafi 4 dhe neni 70 të LPP-së.

Gjykata e Apelit nuk mund ta pranojë mënyrën e vendosjes nga ana e gjykatës së shkallës së parë sipas aktvendimit të ankimuar për arsyeje se kjo gjykatë vlerëson se aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) e LPK-së. Gjendja faktike rezulton të mos jetë vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë me çka ka ardhur edhe deri te aplikimi i gabuar i të drejtës materiale.

Gjykata e Apelit nuk mund ta pranojë këtë qëndrim dhe përfundim të gjykatës së shkallës së parë, për faktin se nuk mund të kuptohet se si ka ardhur deri te një vendosje e tillë lidhur me mos pranimit të dorëzimit të prapësimit, nëpërmes postës. Nga shkresat e lëndës vërtetohet se urdhrin për lejimin e përmbartimit debitori e ka pranuar me datë 02.06.2020, ndërsa prapësimin e ka ushtruar nëpërmes postës rekomande, me datë 05.06.2020, i cili konsiderohet si dorëzim i rregullt i prapësimit në kuptim të dispozitës së neni 127 paragrafi 2 të LPK-së dhe i njëjti është i afatshëm në kuptim të dispozitës së neni 70 të LPP-së, pasi që është parashtruar brenda afatit prej 7 ditësh, gjegjësisht është pranuar në ditën e shtatë, andaj edhe një qëndrim dhe përfundim juridik i gjykatës së shkallës së parë është jo i drejtë dhe i ligjshëm, andaj edhe nga këto arsye është dashur që aktvendimi i atakuar të anulohet dhe çështja ti kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm.

Në ri procedurë, gjykata e shkallës së parë duhet të ketë parasysh vërejtjet e cituara më lartë, të vlerësoj shkaqet e parapara me nenin 71 të LPP-së, duke vendosur në mënyrë meritore lidhur me prapësimin e debitorit e pas kësaj të marr vendim të drejtë dhe të ligjshëm duke i zbatuar dispozitat ligjore në fuqi.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në bazë të neni 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil  
Ac.nr.1008/21, data 22.07.2021

Gjyqtari  
Nehat Idrizi, d.v